

VENDIM
Nr. 111, datë 2.3.2022

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

(ndryshuar me VKM nr. 519, datë 29.7.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare, si dhe në sektorin e industrisë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha:

- a) planifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm urban;
- b) standardet urbane në ndërtim;
- c) hartimi, zbatimi dhe ndjekja e politikave të zhvillimit të infrastrukturës, në të cilat përfshihen infrastruktura, transporti dhe ujësjellës-kanalizimet;
- ç) drejtimi, menaxhimi, mbikëqyrja dhe vendosja e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, të porteve, aeroporteve, ujësjellës-kanalizimeve dhe të digave të mëdha të hidrocentraleve. Përcaktimi dhe vendosja e standardeve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit dhe organizimi i drejtimit të kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit;
- d) monitorimi i realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës në transport, ujësjellës-kanalizime, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar e teknik;
- dh) hartimi dhe zbatimi i monitorimit të trafikut rrugor, detar, ajror dhe hekurudhor përmes sistemeve inteligjente të vendosura në agjencitë, ndërmarrjet dhe drejtoritë e varësisë, për të garantuar sigurinë e çdo sektori të sipërpërmendur, në linjë me parimet ndërkombëtare. Sigurimi i kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operatorëve vendës e të huaj nëpërmjet sistemeve inteligjente, të përshtatshme për t'u përfshirë në sistemet evropiane të informacionit;
- e) sektori i energjisë, i burimeve energjetike, përfshirë edhe burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe eficientia e energjisë;
- ë) hartimi i politikave dhe strategjitë për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike të ardhura si pasojë e veprimtarisë së fushave të përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- f) sektori i hidrokarbureve (naftë dhe gaz);
- g) sektori i minierave dhe gjeologjisë;
- gj) sektori i industrisë joushqimore;
- h) telekomunikacioni dhe shërbimi postar.

3.1 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj edhe në këto fusha:

- a) *Ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për:*

i. hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara;
ii. planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;
iii. drejtimin dhe koordinimin operacional të strukturave dhe të njësisë të veçanta, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, në terren, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit;
iv. ndjekjen, koordinimin, monitorimin e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara autoriteteve përgjegjëse në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, për rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

b) Kontakton dhe bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për:

i. prezantimin e gjendjes dhe të dëmeve të shkaktuara;
ii. përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, si pjesë e programeve të procesit të rindërtimit;
iii. detajimin e nevojave dhe paraqitjen e kërkesave për donacione financiare dhe mbështetje të specializuara njerëzore;
iv. informimin e secilit prej tyre për mënyrën e përdorimit dhe të eficiencës së arritur për çdo donacion apo mbështetje tjetër të ofruar prej tyre.

4. Vendimi nr. 504, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, shfuqizohet.

4.1 Vendimi nr. 650, datë 3.11.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama